

BUXHETI
PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2024

Objektivat e buxhetit 2024

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë si një instiucion i pavarur gëzon bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha institucionet shtetërore dhe private që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në veçanti me Ministrinë e Shëndetësisë, me Urdhrin e Mjekut, Urdhrin e Stomatologut, Urdhrin e Farmacistit si dhe me Komisionin Parlamentar përkatës për përmirësimin e vazhdueshëm të ligjit për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë në përputhje me zhvillimet e reja që sjell koha.

Veprimtaria e Urdhrit të Infermierit në qendër dhe në këshillat rajonale mbështet në të ardhurat e siguruar nga burimet tona të brëndshme ,sipas ligjit të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme dhe që janë bazë për të kryer veprimtarinë ekonomike të këtij institucioni.

Më poshtë po pasqyrojmë realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas treguesve të miratuar nga Këshilli Kombëtar , me ndryshimet përkatëse gjatë vitit 2024, duke bërë dhe krahasimin me vitet e tjera.

A.-Realizimi i të ardhurave për vitin 2024 si dhe në 5-vitet e fundit (2020-2024).

a) Realizimi i te Ardhurave per Vitin 2024, në lekë

Nr	Emertimi	Plani 2024	Realizimi 2024	%
I.	Të ardhurat gjithsej	78,500,000	73,730,077	94
1.	Nga kuotat e antarësisë	26,000,000	25,366,508	98
2.	Nga lejet e reja, për ushtrim profesioni	17,000,000	6,650,072	39
3.	Rinovim për leje të ushtrimit të profesionit	22,000,000	26,963,550	123
4.	Nga kryerja e praktikës profesionale (dosiet)	9,500,000	7,689,370	81
5.	Të ardhura të tjera	4,000,000	7,060,577	175

b) Realizimi i të ardhurave në pesë vitet e fundit (2020-2024) , në lekë

Emertimi	Realizimi 2020	Realizimi 2021	Realizimi 2022	Realizimi 2023	Realizimi 2024
Të ardhurat gjithsej	47,845,284	70,864,460	74,920,678	89,007,759	73,730,077
Nga kuotat e antarësisë	17,838,984	30,678,158	24,304,778	20,513,972	25,366,508
Nga lejet e reja, për ushtrim profesioni	14,190,600	16,916,600	18,404,900	13,240,956	6,650,072
Rinovim për leje të ushtrimit të profesionit	7,015,000	10,860,000	19,215,000	38,207,463	26,963,550

Nga kryerja e praktikës profesionale	7,797,000	10,218,000	10,125,000	9,205,740	7,689,370
Të ardhura të tjera	1,004,500	2,191,702	2,871,000	7,839,628	7,060,577

Planifikimi i të ardhurave

Për vitin 2024 të ardhurat nga **78,500,000** lekë të planifikuara janë realizuar për **73,730,077 lekë** ose **94 %** e planit.

Për sa më lart ,bie në sy tejkalimi i të ardhurave nga riliçensimet për 123 % si dhe të ardhurave të tjera për 175 % ,të cilat vinë nga rritja e numrit të rinovimeve të liçensave.

Nga të dhënat e mësipërme bie në sy mosrealizimi i të ardhurave nga liçensimet e reja për 10,349,928 lekë ,që u përkasin rreth 1600 studentëve të paliçensuar, kjo vjen si pasojë e mos kryerjes në kohë e provimit nga ana e QSHA-së, të cilat kanë sjellë dhe rënien e të ardhurave nga kuotat, të cilat në të ardhurat e vitit 2024 pasqyrojnë vetëm ato të ardhura që i përkasin këtij viti ,të ardhurat e tjera nga kuotat e marra avanc do të pasqyrohen në vitin që ju takon ,të cilat po i pasqyrojmë sipas viteve në tabelën e mëposhtme :

2025	2026	2027	2028
23,035,600	22,899,800	16,741,770	7,163,016

B. Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024

a) Realizimi shpenzimeve per vitin 2024 ,

në lekë

Nr.	Shpenzimet sipas zërave	Plani i 2024	Realizimi 2024	%
I.	Shpenzimet gjithsej	79,318,940	73,955,577	93
a	Shpenzimet për pagat bruto	26,634,140	26,672,312	100
b	Shpenzimet për sigurimet shoqërore	4,071,885	4,157,152	102
c	Honorare te përhershme (paga e te zgjedhurve)	11,212,915	11,086,195	99
d	Shperblime locale, qendrore dhe administrative	14,700,000	10,852,612	74
e	Shpenzime materiale, Kombetare ,Nderkombetare .	22,700,000	21,187,306	93

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, gjatë vitit 2024 janë kryer **73,955,577 lekë** shpenzime operative, nga **79,318,940 lekë** të parashikuara ,ose **93** për qind të planit vjetor. Në sy bie mos realizimi i shpenzimeve në shpërblimet lokale dhe ato qëndrore me 74 % , të cilat nuk janë realizuar sipas planit duke qenë se një pjesë e shpërblimeve (honorareve) ,janë sjellë në muajn janar 2025 nga një pjesë e qarqeve.